



REPUBLIKA E SHQIPERISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Drejtoria e Hetim Inspektimit

Nr. 4148/13 Prot

Tiranë, më 28/02/2013

Lënda : Mbi kundërvajtjen administrative të kontrolluesit, **Kompania "Euromax",**
me adresë : Autostrada Tiranë-Durrës, Km 7, QTU – Kashar, Tiranë.

VENDIM

Nr. 04, datë 28/02/2013

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale", pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të Kompania "Euromax", Tiranë;

KONSTATOVA

Më datë 20/12/2012, nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është zhvilluar inspektimi administrativ pranë kontrolluesit, kompania "Euromax", Tiranë, i cili mbledh dhe përpunon të dhëna personale të pacientëve, në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit të tij, me objekt:

➤ **Verifikimi i zbatimit të Rekomandimit të Komisionerit Nr.40/5, datë 09.12.2011, dhënë ndaj kontrolluesit Kompania "Euromax", Tiranë, sipas të cilit:**

1. Kontrolluesi, kompania "Euromax" sh.p.k Tiranë, në zbatim të nenit 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 " Për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe neneve 81-85 të K.Pr. Administrative të raportojë pranë Komisionerit mbi masat që janë marrë në kuadër të përmbushjes së detyrimeve ligjore të lëna, nëpërmjet rekomandimit nr. 40/2 prot, datë 21.3.2011 të Komisionerit, duke paraqitur edhe provat përkatëse.

Konkretisht, duhet të raportohet në lidhje me pikat 2, 3 dhe 4 të rekomandimit të sipërcituar.

Pikat 2, 3 dhe 4 të Rekomandimit nr. 40/2 prot, datë 21.3.2011, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si më poshtë vijojnë:

2. Verifikimin nëse, kontrolluesi, kompania “Euromax” sh.p.k Tiranë, në zbatim të nenit 3, paragrafi 12, nenin 6, pika 1, shkronja “a” dhe neni 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i cili përpunon të dhëna personale të klientëve dhe realizon marketing të drejtpërdrejtë nëpërmjet mesazheve (sms) në telefonat celular të tyre, ka siguruar deklaratën specifike për dhënien e pëlqimit nga ana e këtyre personave për :
 - a) përpunimin e të dhënave personale;
 - b) marrjen e mesazheve(sms).

Kjo deklaratë dhe dhënia e autorizimit duhet të jetë e ndarë dhe e veçantë për të dyja kategoritë e mësipërme, ku subjekti i të dhënave personale (klientët) duhet paraprakisht të informohen, në mënyrë të shkruar se për çfarë konkretisht është duke dhënë pëlqimin; gjithashtu Formula e dhënies së pëlqimit duhet të jetë e ndarë në, dhënien e pëlqimit nëpërmjet nënshkrimit të klientit për përpunimin e të dhënave dhe, për dërgimin e materialeve informuese, publicitare ose promocionale. Të gjitha këto duhet të jenë të parashikuara në Kartën e anëtarësisë (Application form) e cila i jepet klientit nga kontrolluesi. (sipas pikës 2 të këtij Rekomandimi);

3. Në zbatim të nenit 18 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të dhënave personale”, kontrolluesi kompania “Euromax” sh.p.k, Tiranë, të vendosë tabela paralajmëruese për vëzhgimin me kamera të të gjitha ambienteve të brendshme, të kontrolluesit, të cilat janë të pajisura me sistemin survejues.
4. Në zbatim të nenit 27/2, gërma “ç” të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të dhënave personale”, kompania “Euromax” sh.p.k, Tiranë, duhet të përcaktojë në një dokument ligjor, ose në kontratën sipërmarrëse lidhur me shoqërinë e ruajtjes dhe sigurisë fizike, “Pelican Security” sh.p.k., të drejtat dhe detyrimet e palëve në lidhje me aksesin dhe personat e autorizuar në të dhënat personale që, përpunohen nëpërmjet sistemit të videosurvejimit.

Nga kontrolli administrativ, lidhur me përmbushjen e detyrimeve të dala nga ky rekomandim, kontrolluesi kompania “Euromax”, Tiranë, rezultoi si vijon:

-Kontrolluesi, kompania “Euromax”, Tiranë, nuk ka përmbushur plotësisht pikën 2 të Rekomandimit 40/2 prot, datë 21.3.2011, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi që, ky kontrollues vazhdon të grumbullojë në formularin e kartës së anëtarësisë të klientit (aplication form) të dhënat “Statusi civil” dhe “Arsimi” për të cilat ishte rekomanduar, që të mos i mblidhte në këtë formular;

Gjithashtu, ky kontrollues, ishte rekomanduar nga Komisioneri, të siguronte deklaratën specifike për dhënien e pëlqimit, në lidhje me:

- a) përpunimin e të dhënave personale;

b) marrjen e mesazheve(sms). Kjo pikë është realizuar në kartën e anëtarësisë së klientit.

Kjo deklaratë dhe dhënia e autorizimit i është rekomanduar kontrolluesit, të jetë e ndarë dhe e veçantë për të dyja kategoritë e mësipërme, ku subjekti i të dhënave personale (klientët) duhet paraprakisht të informohen, në mënyrë të shkruar se për çfarë konkretisht është duke dhënë pëlqimin, gjithashtu Formula e dhënies së pëlqimit duhet të jetë e ndarë në dhënien e pëlqimit nëpërmjet nënshkrimit klientit, për përpunimin e të dhënave dhe për dërgimin e materialeve informuese, publicitare ose promocionale. Të gjitha këto duhet të jenë të parashikuara në Kartën e anëtarësisë (Application form) e cila i jepet klientit nga kontrolluesi, gjë të cilën kontrolluesi nuk e ka zbatuar, duke mos përmbushur detyrimin që rrjedh nga nenet 3, 12, neni 6 dhe 18 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të dhënave personale”.

-Kontrolluesi, kompania “Euromax”, Tiranë, e ka përmbushur pikën 3 të Rekomandimit 40/2 prot, datë 21.3.2011 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke realizuar detyrimin për vendosjen e tabelave paralajmëruese për vëzhgimin me kamera të të gjitha ambienteve të brendshme, të kontrolluesit, të cilat janë të pajisura me sistemin survejues, duke zbatuar detyrimin që rrjedh nga neni 18 të nr. 9887 datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

-Kontrolluesi, kompania “Euromax”, Tiranë, nuk e ka plotësuar pikën 4 të Rekomandimit 40/2 prot, datë 21.3.2011 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke realizuar detyrimin për kontratën sipërmarrëse lidhur me shoqërinë e ruajtjes dhe sigurisë fizike, “Pelican Security” sh.p.k., të drejtat dhe detyrimet e palëve në lidhje me aksesin dhe personat e autorizuar në të dhënat personale që përpunohen nëpërmjet sistemit të videosurvejimit, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga neni 27/2, gërma “ç”, të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të dhënave personale”.

Pas detyrave të lëna nga grupi i kontrollit në proces verbalin e datës 13.02.2013, mbajtur midis kontrolluesit, kompania “Euromax” Tiranë dhe grupit të kontrollit, ky kontrollues pati një reagim të menjëhershme, në lidhje me korrigjimin e shkeljeve të konstatuara. Duke marrë parasysh dhe ndryshimet e herëpashershme, që kjo kompani ka patur në drejtuesit e saj, grupi i kontrollit rivefikoi masat e menjëhershme të marra nga ana e drejtuesve të sapozgjedhur në krye të kësaj kompanie.

Në datë 25/02/2013, pranë kontrolluesit “Euromax”, u ushtrua kontrolli administrativ lidhur me zbatimin e detyrave të lëna në procesverbalin e kontrollit administrativ të ushtruar në datën 13/02/2013 nga drejtoria e Hetim-Inspektimit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Në ambientet e kontrolluesit “Euromax” u kontaktua me përfaqësuesin ligjor z. Erjon Tema, administratorin e teknologjisë dhe informacionit si dhe administratorin e përgjithshëm të kompanisë “Euromax”.

Gjatë inspektimit administrativ lidhur me detyrat emergjente të lëna nga grupi i kontrollit administrativ në procesverbalin e datës 13/02/2013 për kontrolluesin “Euromax” u konstatua se:

1. Lidhur me pikën e parë të procesverbalit: *...për shkatërrimin e të dhënave personale “arsimi” dhe “statusi civil” të klientëve...* kontrolluesi e ka zbatuar këtë pikë të detyrave emergjente të lëna (bashkëlidhur printime të bazës së të dhënave përpara dhe mbas realizimit të kësaj detyre të lënë në procesverbal);

2. Lidhur me pikën e dytë të procesverbalit: "... për hartimin e formularit të klientit dhe dërgimin për miratim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale..." konstatohet se, kontrolluesi është përpjekur të realizojë diçka, por duket që nuk ka njohuritë e duhura, pasi që, në këtë formular ka ende dy kategori të dhënash, "Arsimi" dhe "Statusi civil", për të cilat nga ana e Komisionerit ishte rekomanduar që këto dy kategori mos ishin pjesë e kartës së anëtarësisë (aplication form), por të ideoeshin të inkorporuara në deklaratën e dhënies së pëlqimit. Deklarata e pëlqimit, është një prej detyrave që mbetet për tu realizuar nga ky kontrollues, të cilit i ofrohet konsulenca dhe asistenca e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
3. Lidhur me pikën e tretë të procesverbalit: "...për ndalimin e mbledhjes së të dhënave personale të klientëve apo regjistrim të klientëve të rinj..." u konstatua se drejtuesi juridik i kontrolluesit "Euromax" ka urdhëruar ndërprerjen e mbledhjes së të dhënave deri në momentin e miratimit të formularit të ri të aplikimit nga zyra e Komisionerit.

Pas riverifikimit, konstatohet se kontrolluesi "Euromax" ka përmbushur dy nga pesë pikat emergjente për tu zbatuar, të lëna nga grupi i kontrollit administrativ në procesverbalin e datës 28/01/2013. Dy pikat e fundit të detyrave emergjente për tu zbatuar nga kontrolluesi janë në funksion të miratimit të formularit të ri të aplikimit nga zyra e Komisionerit.

Në këto kushte, konstatoj se, kontrolluesi, kompania "Euromax" Tiranë, për arsye të qenësishme nuk i ka përmbushur në afatin e caktuar detyrimet që rrjedhin nga Rekomandimi i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me 40/2 prot, datë 21.3.2011, pavarësisht faktit se, reagimi i stafit të ri ishte i menjehershëm, pas kontrollit të grupi të inspektimit.

Sa më sipër, ligjërisht vlerësoj se, nga kontrolli administrativ, i ushtruar prej Drejtorisë së inspektimit, mbi përmbushjen e Rekomandimit 40/2 prot, datë 21.3.2011 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pranë kontrolluesit, kompania "Euromax" Tiranë, më datë 20.12.2012, është konstatuar se nuk ka zbatuar plotësisht detyrimet ligjore të lartpërmendura.

- Moszbatimi tërësisht i paragrafit 2, të Rekomandimit 40/2 prot, datë 21.3.2011 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, e ngarkon kontrolluesin me përgjegjësi administrative të parashikuar në nenin 39 pika 1, gërma "a", të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", ku parashikohet dënimi me gjobë nga 10.000 deri në 500.000 lekë.

-Moszbatimi i paragrafit 2, të Rekomandimit nr. 40/2 prot, datë 21.3.2011 të Komisionerit, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, e ngarkon kontrolluesin me përgjegjësi ligjore të parashikuar në nenin 30, paragrafi 2 pika 1, të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

- Moszbatimi tërësisht i paragrafit 4, të Rekomandimit 40/2 prot, datë 21.3.2011, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, përbën shkelje të nenit 27, paragrafi 2, gërma "ç", të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", dhe e ngarkon kontrolluesin, me përgjegjësi administrative të parashikuar në nenin 39 pika 1, gërma "dh", ku parashikohet dënimi me gjobë nga 10.000 deri në 150.000 lekë.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Komisioneri ka parasysh shkallën e njohjes, masat reaguese dhe të menjehershme që keni marrë për implementimin e ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".

Nisur sa më sipër, në zbatim të neneve 21-23, 30/2, 39/1,4; 40 e 41, të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, 107-109 të K.Pr.Administrative, si dhe Nenit 18/a, c të Ligjit Nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative”:

V E N D O S A

- 1 Dënimin e Kontrolluesit, Kompania “Euromax” Tiranë, me gjobë, si më poshtë:
 - I/ a. Bazuar në nenin 39, paragrafi 1, gërma “a”, të Ligjit Nr.9887, datë 10.3.2008, “ Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me vlerën 100.000 (njëqindmijë) lek.
 - I/ b. Bazuar në nenin 39, paragrafi 1, gërma “dh”, të Ligjit Nr.9887, datë 10.3.2008, “ Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me vlerën 50. 000 (pesëdhjetëmijë) lek.
- 2 Të mos mblidhen të dhëna personale të klientëve deri në miratimin e formularëve të rinj.
- 3 Të përmbushet, detyrimi ligjor që buron nga Rekomandimi Nr.40/5, datë 09.12.2011, e për pasojë dhe i Rekomandimit 40/2 prot, datë 21.3.2011 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, konkretisht, në lidhje me pikën 2, të parashikuar në këtë rekomandim, në zbatim të neneve 5, 6 dhe të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”: të mos mblidhen në formularin, “Për aplikimin e kartës së anëtarësisë”, (formulari ekzistues), të dhënat “*statusi civi*” dhe “*arsimi*”;
- 4 Të hartohet formulari i ri i aplikimit të klientëve, sipas rekomandimit nr.40/2 prot, datë 21.3.2011, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me qëllim dërgimin e mesazheve promovionale, ku subjektet e të dhënave të informohen, në lidhje me këtë përpunim, si dhe tu mundësohet dhënia e pëlqimit të shprehur. Për hartimin e këtij akti, Zyra e Komisionerit ofron asistencën e saj;
- 5 Të përmbushet, detyrimi ligjor që buron nga Rekomandimi 40/2 prot, datë 21.3.2011, i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dhe konkretisht, në lidhje me pikën 4, të parashikuar në këtë rekomandim, në zbatim të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të dhënave personale”, mbi hartimin e masave mbrojtëse për të dhënat personale të klientëve, të cilat mbahen manualisht, duke i inkorporuar këto masa, në rregulloren aktuale të hartuar nga kontrolluesi. Për hartimin e këtij akti, Autoriteti i Komisionerit ofron asistencën e tij;
- 6 Pas miratimit të formularëve të rinj të bëhet përditësimi i të dhënave të të gjithë klientëve ekzistues.
- 7 Për klientët të cilët nuk kanë bërë përditësimin apo nuk kanë dhënë pëlqimin, të merren masa për shkatërrimin e të dhënave të mbledhura.
- 8 Detyrimet që rrjedhin nga ky vendim të përmbushen brenda një afati 45 (dyzetepesë) ditor.
- 9 Me plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

- 10 Gjoha, arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 ditë nga komunikimi i këtij vendimi;
- 11 Me kalimin e këtij afati, ky vendim shndërrohet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit;
- 12 Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit.

Ky vendim u dha sot me datë, 28.02.2013.

Komisioneri

Flora Çabej (Pogaçe)

